

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

Për

Vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko - financiare në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Durrës.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Angazhimi i auditimit mbi vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko financiar në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Durrës (QNOD) u ushtrua në zbatim të Urdhrit të MM nr.1631, datë 18.10.2018 “Për miratimin e planit strategjik dhe vjetor të auditit për vitin 2019” si dhe në programin e punës miratuar nga Drejtori i Auditimit të Brendshëm nr. 1014, datë 15.02.2019.

Misioni i auditimit u krye prej datës 18.02.2019 - 31.03.2019 nga grupi i punës i përbërë nga z.Idriz Gjonaj dhe z.Edvin Zoto me detyrë Inspektor/audit, me objekt: “Auditim i veprimtarisë ekonomiko-financiare, vlerësimi në thellësi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, risqet e përgjithshme me të cilat përballet njësia, indentifikimi i mangësive dhe ndërmarrja e veprimeve korrigjuese, saktësimi fizik dhe kontabël i pronave për aktivitetin e ushtruar nga kjo njësi për periudhën 01.01.2016 - 31.12.2018”.

HYRJE

Auditimi u krye bazuar në ligjin nr. 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Manualin e auditimit të brendshëm në sektorin publik”, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kodin Etik dhe Kartën e Auditimit të Brendshëm Publik”.

Qëllimi i misionit të auditimit ishte vlerësimi i veprimtarisë ekonomiko financiare të institucionit në tërësi dhe në veçanti për fushat me risk ku kërkohet një vlerësim më i madh përkatësisht në sistemin e programimit dhe zbatimin e buxhetit, sistemi i prokurimeve, sistemi i pagesave për paga e shtesat mbi page të punonjësve, në pagesat për udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, pagesat për ndërtime e konstruksione, furnizimet me mallra e materiale, punime e shërbime të ndryshme, në sistemin e kontabilitetit, fushat e menaxhimit dhe administrimit te aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale, inventarizimi i aktiveve, vlerësimi i atyre të nxjerra jashtë përdorimi, etj.

METODA E AUDITIMIT

Grupi i punës gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit, aplikoi auditimin në bazë sistemi nëpërmjet auditimit financiar për aktivitetin ekonomiko financiar te ushtruar nga ky repart, auditimit të përputhshmërisë të veprimeve të kryera me rregullat dhe dispozitat ligjore në fuqi, të leximit të raporteve të auditimit mëparshëm për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve.

Gjatë kryerjes së auditimit grupi i punës ka përdorur metoda auditimi të veçanta dhe të kombinuara, si metodën e rindërtimit te ngjarjeve, metodën e ekzaminimit, metodën e rishikimit analitik, ecja përmes, intervistimit, metoda e ndjekjes së dokumentacionit, metodën e konfirmimit dhe ekzaminimit kryq etj, ndërsa si teknika të auditimit janë përdorur testet dhe sondazhet për të gjitha sistemet e audituara.

konkluzione të përgjithshme:

Nga auditimi vlerësohet se menaxhimi i aktiveve materiale duhet të jetë më i kujdesshëm në përdorimin e tyre me efektivitet dhe efizienzë, nëpërmjet njohjes dhe zbatimit të legjislacionit përkatës dhe kryerjes së kontrolleve të brendshme, parandaluese e zbuluese, pasi gjatë auditimit janë konstatuar parregullsi, si më poshtë;

1. Funksionimi në vazhdimësi i sistemit të kontrollit të brendshëm (tërësia e rregullave të vendosura nga drejtimi), është përqendruar vetëm në kontrolle fizike. Konstatohet mungesë e përvojës në mos njohjen e legjislacionit dhe procedurave, për llogaritjen e shkarkimeve të karburanteve, teknikës e kazermimit, nga personeli që menaxhon dhe administron fondet financiare dhe vlerat materiale
2. Në organizimin, mbajtjen dhe zbatimin e kontabilitetit, pasqyrimin e vlerës reale të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, në regjistrimin dhe klasifikimin e tyre, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar
3. Sektori i financës të marrë masa për hapjen menjëherë të regjistrit të pagave të çdo punonjësi me të gjithë elementët e tij (pagat për funksion, shtesat dhe ndalesat etj të dhëna sipas udhëzimeve për këtë qëllim)
4. Nga vlerësimi i rregullshmërisë së shkarkimit nga librat e llogarisë të aktiveve të konsumit, si: karburante, materiale elektrike, hidraulike, kancelari, aktive të higjienës e pastrimit, konstatohet se këto aktive janë shkarkuar direkt nga magazina qendrore vetëm me fletë dalje, pa pasur një dokument argumentues për përdorimin dhe shkarkimin e tyre dhe nuk janë përcaktuar norma konsumi, duke vepruar në shkelje të kërkesave ligjore. Në fakt shkarkimi duhet të bëhet me proces verbal për çdo muaj, të miratuar nga Drejtori Administrativ i QNOD-së dhe i nënshkruar nga jo më pak se dy persona, përveç përgjegjës material.
5. Aktivitet e vendosura në zyrat e personelit të QNOD-së shkarkohen padrejtësisht nga magazina qendrore, si dalje të jashtëme, dhe ngarkohen punonjësit e zyrave, kur në fakt ato duhet të jenë gjendje në inventarin e magazinës dhe kalimi tek punonjësit të bëhet nëpërmjet kartelave kundrejt nënshkrimit të tyre
6. Administrimi dhe shkarkimi i karburantit, nuk është bërë konform kërkesave ligjore, pasi në shkarkimin e karburantit nuk ka urdhër apo plan shpërndarje, nuk është hedhur sasia e karburantit të tërhequr nga drejtuesit e mjeteve, nuk bëhet analizë për konsumin dhe shkarkimin e karburantit, si dhe fletët e udhëtimit nuk janë sipas modelit të miratuar nga Ministria e Mbrojtjes
7. Në urdhrat e brendshëm për kryerjen e inventarizimit të aktiveve nuk janë përcaktuar afatet e kryerjes së inventarëve për cdo objekt dhe njësi inventarizuese; nuk janë përcaktuar udhëzime mbi rregullat e kryerjes së inventarëve. Aktivitet që ndodhen nëpër zyra nuk janë në administrim të magazinierit materialisht përgjegjës, por i kanë në administrim punonjësit e administratës. Nuk është kryer inventar për ndërtesën në administrim të QNOD-së.

Auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm.

Funksionimi organizativ

Struktura organizative e QNOD-së është e përcaktuar me VKM nr.439, datë 13.05.2011 "Për miratimin e dokumentit "Politikat dhe procedurat e funksionimit të QNOD-së e ndryshuar si dhe në urdhrin e kryeministrit nr.116, datë 18.07.2016 "Për miratimin e organikës së QNOD-së.

Ky institucion për periudhën 01.01.2016 - 18.07.2016, ka funksionuar me emërtimin Qendra Ndërinstitucionale Operacionale, sipas urdhrin të Kryeministrit nr.82, datë 12.04.2010 "Për miratimin e organikës së QNOD" me përbërje totale 28 persona. Për periudhën nga 18.07.2016 - 31.07.2018 ka funksionuar sipas urdhrin të Kryeministrit nr.116, datë 18.07.2016 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së QNOD" me përbërje totale prej 26 persona dhe për periudhën nga 31.07.2018 e në vazhdim ka funksionuar sipas urdhrin të Kryeministrit nr.119, datë 31.07.2018 "Për disa ndryshime në urdhrin nr.116, datë 18.07.2016 të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare", struktura organike e të cilit është: 1) Drejtori ekzekutiv 2) Drejtori planifikimit & shërbimeve mbështetëse, i përbërë nga tre sektorë 3)Sektori i administratorëve të sallës dhe 4) Sektori i sekretarisë & arkiv-protokollit, me përbërje totale prej 24 persona.

Ndërtimi i strukturës së QNOD-së ka qenë në funksion të realizimit të misionit dhe detyrave për sigurimin e vëzhgimit të hapësirës detare shqiptare për të realizuar organizimin, planëzimin, bashkërendimin dhe drejtimin e operacioneve në det, në përputhje me legjislacionin detar kombëtar dhe ndërkombëtar.

Vlerësimi i mjedisit të kontrollit, planifikimi dhe menaxhimi i riskut

Nga auditimi konstatohet se për periudhën e audituar, personeli menaxhues dhe zbatues i kësaj njësie ka ndryshuar dy herë: dy drejtues të këtij institucioni, dy përgjegjës të sektorit të financës, ndërsa të pa ndryshuar kanë mbetur drejtori i planifikimit dhe shërbimeve mbështetëse, sektorët e tjerë, i administratës, i llogarisë etj. Ekziston rregullorja e brendshme e QNOD-së, e miratuar me urdher të Drejtorit Administrativ nr.131, datë 01.11.2016 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e QNOD-së", në të cilën pasqyrohen përshkrimi i detyrave të çdo strukture në QNOD. Për vitet 2016 - 2018 nuk ka pasur planifikim për riskun dhe menaxhimin e tij, ka pasur mungesë njohurish, për identifikimin dhe krijimin e regjistrin të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave të institucionit.

Kontrolli i aktiviteteve dhe monitorimi i tyre

Nga auditimi vlerësohet se menaxhimi i burimeve financiare dhe ato ekonomike, duhet të ishin bërë më me efektivitet dhe efikasitet nëpërmjet planifikimit dhe kryerjes së kontrolleve parandaluese e zbuluese para dhe pas faktit, pasi janë konstatuar parregullsi e shkelje të cilat janë trajtuar hollësisht në çështjet përkatëse, në aktivitetin e kryerjes së pagesave sipas fushave përkatëse:

Rekomandim: Për një menaxhim me efektivitet të aktiveve në përdorim të repartit, titullari i QNOD-së, përveç përcaktimit të misionit dhe objektivave, duhet të hartojë plane konkrete veprimi të cilat duhet të përmbajnë afate kohore dhe persona përgjegjës për realizimin e tyre, të përcaktojnë qartë detyrat dhe përgjegjësitë për personelin e emëruar në vende pune të cilët menaxhojnë aktivitetet e forcimit të kontrollit të brendshëm në çdo aktivitet të saj, sipas sistemeve dhe fushave, si dhe trajnim të vazhdueshëm të personelit në drejtim të njohjes së legjislacionit.

Plani i detyrave të lëna nga auditimet e mëparshme

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimeve të plota apo specifike të kryera në QNOD rezulton se :

Në këtë njësi është ushtruar një mision auditimi angazhim i plotë me objekt "vlerësimi i veprimtarisë ekonomike financiare" për periudhën 01.04.2010 – 31.12.2015.

Rekomandimet e lëna nga auditimi në urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 1054, datë 31.05.2016 "Mbi përfundimet e angazhimit të auditimit të ushtruar në QNOD" janë marrë në konsideratë nga Titullari i njësisë dhe është hartuar prej tij plani i veprimit nr. 94, datë 21.06.2016 me detyra, afate konkrete dhe persona përgjegjës.

Masat e përcaktuara në urdhërin e MM me karakter organizativ janë ndjekur, janë nxjerrë aktet përkatëse dhe janë realizuar.

Masat e përcaktuara në urdhërin e MM me karakter zhdëmtimi në vlerën 114,209 lekë në ngarkim të 18 punonjësve të QNOD janë arkëtuar nga financa e kësaj njësie me përjashtim të vetëm një rasti të znj. Vilma Qerama në vlerën 4,785 lekë e cila është larguar jashtë vendit.

Nga ana e QNOD është raportuar në Drejtorinë e Auditimit për realizimin e rekomandimeve të lëna me shkresën nr.676/1, datë 16.11.2018

II. Menaxhimi ekonomik financiar.

1. Vlerësimi i procedurave të ndjekura për programimin e nevojave buxhetore, përgatitjen e buxhetit, detajimi vjetor, ndryshimet e bëra gjatë vitit bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Realizimi i buxhetit vjetor dhe investimeve, sipas programeve dhe projekteve

Menaxhimi buxhetit për vitet 2016–2018, është mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar si dhe në udhëzimet e dërguara nga MF, MM dhe SHPPFA, mbi zbatimin e buxheteve të viteve përkatëse. QNOD për këtë periudhë ka funksionuar si njësi shpenzuese, duke mbuluar edhe nevojat buxhetore për kryerjen e pagave të punonjësve dhe shpenzimet korente e kapitale të saj

Programimi i nevojave buxhetore për artikujt 600 dhe 601 është bazuar në numrin e punonjësve të miratuar sipas strukturës organike të këtij institucioni dhe kategorive përkatëse të tyre (ushtarakë dhe civil) duke llogaritur pagën për gradë apo për funksion sipas tabelave të pagave përkatëse, ndërsa fondet e kontributeve për sigurime janë llogaritur në bazë të tarifave përkatëse. Programimi i nevojave buxhetore për artikujt 602 dhe 606 është bazuar në planet afatgjatë të zhvillimit të QNOD-së, parashikimin e aktiviteteve kryesore, plotësimin e objektivave të modernizimit dhe përmirësimit të infrastrukturës etj.

Për periudhën e audituar 01.01.2016 – 31.12.2018 u konstatua se detajimi i fondeve buxhetore për QNOD është dërguar sipas shkresave të MM, në nivel artikulli, n/artikulli dhe zë shpenzimi.

Nga auditimi i pasqyrave dhe situacioneve financiare vjetore rezulton se buxheti për periudhën 2016-2018 paraqitet si më poshtë;

Ndryshimet e fondeve të bëra gjatë vitit 2018 janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe kompetencat e përcaktuara për nëpunësit autorizues sipas nivelit dhe autoritetit përkatës, ndërsa për periudhën 2016-2017 nga ana e sektorit të financës nuk janë kërkuar ndryshime të fondeve, megjithëse në fund të këtyre viteve artikujt të veçante kanë realizuar me mosrealizime.

Situacionet e shpenzimeve buxhetore në nivel artikulli dhe nën artikulli janë plotësuar çdo muaj e në mënyrë progresive, konfirmuar nga Dega e Thesarit Durrës për planin fillestar, ndryshimet dhe shpenzimet faktike dhe janë dërguar në MM sipas afateve ligjore. Ndryshimet e fondeve të bëra gjatë viteve 2016-2018 janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe kompetencat e përcaktuara për nëpunësit autorizues sipas nivelit dhe autoritetit përkatës.

Për periudhën 01.01.2016 - 31.12.2016, QNOD-së i janë akorduar fonde, me shkresë nr.119/2, datë 27.01.2016 nga Sekretari i Përgjithshëm në MM në shumën 23,200,000 lekë dhe në total fondet buxhetore janë realizuar në shumën 22,289,364 lekë, ose në masën 96% me një diferencë (mosrealizim) prej 910,636 lekë, nga e cila, me mosrealizimin më të theksuar rezulton artikulli 602 "Mallra dhe shërbime" në shumën 201,526 lekë, artikulli 600 "Paga, shpërblime dhe të tjera" në shumën 446,670 lekë dhe artikulli 601 "Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore" në shumën 244,989 lekë. Nga ana e sektorit të financës nuk janë kërkuar ndryshime të artikujve të mësipërm nga struktura eprore, me qëllim realizimin e fondeve sipas planit të miratuar.

Për periudhën 01.01.2017 - 31.12.2017, QNOD-së i janë akorduar fonde, me shkresë nr.1086/1, datë 20.02.2017 nga Sekretari i Përgjithshëm në MM në shumën 27,862,000 lekë dhe në total fondet buxhetore janë realizuar në shumën 27,374,134 lekë, ose në masën 98.2% me një diferencë (mosrealizim) prej 487,866 lekë., nga e cila, me mosrealizimin më të theksuar rezulton artikulli 600 "Paga, shpërblime dhe të tjera" në shumën 367,987 lekë dhe artikulli 602 "Mallra dhe shërbime në shumën 94,208 lekë.

Për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2018, QNOD-së i janë akorduar fonde, me shkresë nr.876, datë 07.02.2018 nga Sekretari i Përgjithshëm në MM në shumën 28,400,000 lekë, janë ndryshuar (pakësuar) nga struktura eprore në shumën 2,109,200 lekë dhe në total fondet buxhetore janë realizuar në shumën 24,832,089 lekë, ose në masën 94.45% me një diferencë (mosrealizim) prej 1,485,711 lekë, nga e cila, me mosrealizimin më të theksuar rezulton artikulli 600 "Paga, shpërblime dhe të tjera" në shumën 1,051,469, ose në masën 94.9% lekë dhe artikulli 601 "Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore" në shumën 329,567 lekë, ose në masën 90.27 %.

Konkluzione: Fakti që ndryshimet (shtim, pakësime) gjatë viteve 2016-2018 janë të theksuara, tregon që kërkesat e bëra nga specialistët e financës dhe sektorët e tjerë nuk kanë qenë të argumentuara me nevojat reale se plani fillestar i ardhur nga struktura eprore ka qenë jo real, me rezerva dhe i pa argumentuar sipas nevojave reale të këtij institucioni dhe me limitet e miratuara dhe të dërguara nga strukturat eprore. Mosrealizimet e konstatuara në total dhe për artikuj e për nën artikuj të veçantë tregojnë se seksioni financës dhe sektorët e tjerë që u janë miratuar dhe menaxhojnë fonde financiare, nuk kanë ndjekur me përgjegjësi realizimin e treguesve financiar gjatë gjithë periudhës ushtrimore në nivel artikulli dhe n/artikulli, fakti që gjatë viteve 2016-2017 nuk janë kërkuar ndryshime të artikujve me mosrealizime e vërtetojnë opinionin e auditit.

2. Vlerësimi i sistemit të pagave, procedurave të përgatitjes së listë pagesave si dhe zbatimi i dispozitave ligjore për pagat, shtesat mbi pagë e llogaritjet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, respektimi i organikës dhe limiteve.

Për vlerësimin e sistemit të pagesave, objektivi i audituesit ka qenë, saktësia dhe bazueshmëria ligjore, kryesisht, në pagesat sipas funksioneve organike dhe shtesat e tyre, pagesat e lejeve të pakryera brenda vitit ushtrimor, pagesat për kompensimet ushqimore në vlerë leku, pagesat për shpërblime nga fondi veçantë, emërimi dhe largimi i punonjësve dhe përfitimet shtesë të tyre, fusha këto që përfshihen në sistemin e pagave dhe konstatohet si më poshtë:

Sistemi i pagesave për paga, shtesa mbi to dhe shpërblime të personelit të QNOD-së, u audituan sipas programit të miratuar për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2018.

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare për periudhën nga 01.01.2016 - 31.12.2018 ka funksionuar me organizim ekonomik-financiar buxhetor, me likuidime të kryera nga vetë struktura.

Emërimi dhe largimi i punonjësve është bërë në bazë të propozimeve të Titullarit të QNOD-së dhe urdhrave të strukturave kompetente për emërimin dhe largimin e punonjësve të këtij institucioni.

Për vendosjen e punonjësve sipas funksioneve dhe vendeve të punës janë miratuar Strukturat dhe Organikat e këtij institucioni sipas urdhrave të Kryeministrit nr.82, datë 12.04.2010 "Për miratimin e organikës së Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare", urdhrit të Kryeministrit nr.116, datë

18.07.2016 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare" dhe urdhrin të Kryeministrit nr.119, datë 31.07.2018 "Për disa ndryshime në urdhrin nr.116, datë 18.07.2016 të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare", për periudhën 01.01.2016-31.12.2018 ky Institucion e ka kryer funksionin organizativ sipas këtyre urdhrave nga 01.01.2016 e në vazhdim.

Duke ballafaquar strukturën e funksioneve organike sipas Strukturave dhe organikave të miratuara me limitet e miratuara nga organet eprore për shpërndarjen e numrit të personelit për periudhën 01.01.2016 - 31.12.2018 konstatohet se nuk janë kryer pagesa mbi limitin e miratuar.

Nga vlerësimi i listë-pagesave të punonjësve civil dhe ushtarakëve, që ka pasur në marrëdhënie pune dhe financiare QNOD-ja, për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2018, duke verifikuar për gjithë personelin, saktësinë dhe përputhshmërinë e pagës për gradën ushtarake përkatëse dhe vitet e shërbimit për përfituesit ushtarakë dhe pagat për klasë për punonjësit civil, përfitimin e shtesave për kushte të veçanta pune e shërbimi, shtesat për punë të vështirë e të dëmshme për shëndetin, llogaritjen dhe përfitimin e rritjes së pagës, sipas përcaktimeve të bëra në VKM-të përkatëse, për vitet objekt auditimi, përgatitjen e listë-pagesave dhe shoqërimin e tyre me kohëshënuesin mujor, hartimin e përmbledhësve të listë-pagesave, kryerjen e ndalesave për sigurimet shoqëror, shëndetësor, tatimin mbi të ardhurat dhe tatimin suplementar për ushtarakët, sipas detyrimeve dhe përcaktimeve të bëra në aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe plotësimin e urdhrë pagesave dhe konfirmimin e tyre nga dega e thesarit për likuidim, konstatohet:

Listë pagesat për periudhën objekt auditimi janë përgatitur nga sektori i financës (specialistja e financës), sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike", nr. 4, datë 13.12.2016 "Për formën elementët dhe plotësimin e borderosë së pagave për njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Në vlerësimin e përpilimit të listë-pagesave u konstatua se nga ana e sektorit të financës nuk mbahet regjistër i veçantë për regjistrimin e pagave të çdo punonjësi me të gjithë elementët si paga për funksion, shtesat, ndalesat etj, si element i domosdoshëm për të pasqyruar në çdo kohë informacion për pagat e çdo punonjësi.

Rekomandime: Sektori i financës të marrë masa për hapjen menjëherë të regjistrit të pagave të çdo punonjësi me të gjithë elementët e tij (pagat për funksion, shtesat dhe ndalesat etj të dhëna sipas udhëzimeve për këtë qëllim).

Pagesa e punonjësve civil, për periudhën nga 01.01.2016 - 31.12.2018 është bërë sipas urdhrave nr.116, datë 18.07.2016 i ndryshuar me urdhrin nr.119, datë 31.07.2018 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare". Për të gjitha ndryshimet që u janë bërë pagave punonjësve civil dhe ushtarakë nga ana e specialistes së financës janë bërë përlllogaritjet e reja, të cilat janë pasqyruar në borderonë tip duke vendosur edhe shtesat e tjera mbi pagë që u takojnë civilëve sipas urdhrave të mësipërme dhe nuk u konstatuan përlllogaritje të gabuara

Auditimi i vlerësimit të pagave të ushtarakëve, u krye duke verifikuar saktësinë e llogaritjes së pagave sipas gradave, shtesat që u takojnë sipas VKM-së nr. 839, datë 11.12.2003 "Për pagat e ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" (Lidhja nr. 1- pagat sipas gradës dhe viteve të shërbimit për ushtarakët aktivë të FA, Lidhja nr. 2-Masa e shtesës për natyrë të veçantë që përfitojnë ushtarakët në FA, Lidhja nr. 3 -Funksionet ushtarake që përfitojnë shtesë për punë të vështirë e të dëmshme në shëndet në strukturat e FA.), me të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur gjatë periudhës së audituar dhe VKM-së nr.224, datë 21.03.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë". Për të gjitha ndryshimet që u janë bërë pagës së ushtarakut nga ana e shesës së financës janë bërë

përlllogaritjet e reja, të cilat janë pasqyruar në borderonë tip duke vendosur edhe shtesat e tjera mbi pagë që u takojnë ushtarakëve sipas VKM-ve. Nga ana e auditimit u bënë verifikimet e saktësisë së përlllogaritjeve të pagave dhe nuk u konstatuan përlllogaritje të gabuara.

Përlllogaritja e shpërblimit të menjëhershëm në masën e dy pagave neto mujore, që përfitojnë ushtarakët e dalë në lirim/rezervë është bërë sipas kërkesave të VKM-së nr. 793, date 24.09.2010, i ndryshuar me VKM-në nr. 252 date 09.02.2011 "Për zbatimin e ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar ushtarakeve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të punonjësve të shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në RSH" dhe nuk u konstatuan përlllogaritje të sakta.

Nga vlerësimi i shtesave të pagave për dëmshmëri shëndeti dhe për natyrë të vecantë pune nuk u konstatohet se ato janë përlllogaritur drejt dhe nuk u konstatuan mangësi.

Në përfundim, **opinionit i auditit** është se pagat për ushtarakët dhe punonjësit civil janë përlllogaritur drejt dhe sipas dispozitave ligjore, me përjashtim të rasteve të paraqitura më lart.

Detyrimet e tjera që rrjedhin nga kërkesat e ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet përkatëse për punonjësit civil dhe një ushtarakët janë mbajtur sipas kërkesave të këtij ligji. Konkretisht auditimi u fokusua në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit të mësipërm me të gjitha ndryshimet që u janë bërë atyre nga 01.01.2016 - 31.12.2018. Duke u mbështetur në kërkesat ligjore, nga ana e financës llogaritjet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë bërë të sakta si për pjesën e kontributit që i takon punëdhënësit ashtu edhe për atë që detyrohet ta paguajë punëmarrësi, të ndara këto në përqindje për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, derdhjet janë bërë në kohë në Degën e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Durrës të plota dhe brenda afateve kohore të miratuara.

Auditimi për ndalesat e tatimit nga të ardhurat personale të punonjësve civil dhe ushtarak u bazua në kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar dhe në udhëzimet e dala nga Ministria e Financës në zbatim të ligjit të mësipërm. Konstatohet se ndalesat janë bërë në kohë duke u mbështetur në dispozitat ligjore e nënligjore, të rregullta, ndërsa shumat e ndalura (Tatimi mbi të ardhurat personale) janë derdhur në destinacion brenda afateve ligjore.

Auditimi për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë u ushtrua për periudhën 01.01.2016-31.12.2018 dhe në përfundim të vlerësimit të krijimit dhe përdorimit të fondit të veçantë, rezulton se për periudhën e audituar nuk u konstatuan shpërblime për rezultate të larta në punë, me përjashtim të shpërblimeve për dalhje në pension të punonjësve të këtij institucioni.

3. Auditim mbi vlerësimin e administrimit, ruajtjes dhe lëvizjes së aktiveve:

Auditimi i të gjitha aktiveve të vëna në përdorim brenda njësisë, sipas vend ndodhjes, në magazinë dhe në përdorim të personelit brenda apo jashtë këtij institucioni.

Objektivi i audituesit në vlerësimin e kësaj çështje ishte, vlerësimi i procedurave dhe rregullave të vendosura nga QNOD-ja për administrim dhe ruajtjen e të gjitha aktiveve, zbatimin e ligjshmërisë në lëvizjen e aktiveve, rregullave për inventarizimin e nxjerrjen jashtë përdorimi të tyre, funksionimin e kontrollit të brendshëm.

U audituan të gjitha aktivitetet e vëna në përdorim brenda institucionit, si ato në përdorim të personelit brenda ambienteve të punës. Gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit u aplikua auditim në bazë sistemi, nëpërmjet auditimit të përputhshmërisë së kryerjes së aktivitetit me rregullat dhe dispozitat ligjore dhe auditimit financiar për aktivitetin ekonomik financiar të ushtruar nga kjo struktura.

Para fillimit të kryerjes së angazhimeve të auditimit, u njohëm me rregulloren e brendshme të institucionit, objektivat, veprimtarinë, mjedisin dhe risqet kryesore që kjo njësi ka pasur në ushtrimin e

aktivitetit në funksion të objektivave që ka planifikuar për të arritur. U njohëm me aktivitetin kryesor të këtij institucioni, gjendjen aktiveve qarkulluese, mjetet kryesore e pajisjeve me organizimin e mbajtjen e kontabilitetit dhe administrimin e vlerave materiale.

Nga auditimi u konstatua se për menaxhimin e aktiveve Drejtimi dhe stafi menaxherial janë mbështetur në kërkesat e ligjit nr.9228 datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", rregulloret, urdhrat, udhëzimet e aktet normativave të veçanta të nxjerra nga KM, e MM, si dhe urdhrat e vendimet e nxjerra nga MM.

Regjistrimi i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre, kuadrimi midis magazinës, llogarisë dhe saldove të pasqyruara në pasqyrat financiare.

Objekti i audituesit ishte vlerësimi i punës për organizimin dhe rregullat e vendosura nga drejtoria për ruajtjen e aktiveve dhe administrimin e tyre, regjistrimin në librat e kontabilitetit e pasqyrimi në pasqyrat financiare, marrja në dorëzim, kontrolli periodik i tyre, zbatimi i procedurave për shkarkimi e aktiveve materiale, procedurat e seleksionimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të tyre.

U audituan gjendjet e inventarit, lende të para dhe materiale, objekte inventari dhe mallra. Auditimi u krye me zgjedhje në drejtim të dokumentimit të vlerave materiale, si flete-hyrje, flete-dalje, të shoqeruara me dokumentacion justifikues.

Nga auditimi i dokumentacionit të këtyre periudhave u konstatua se në përgjithësi janë zbatuar rregullat sipas dispozitave ligjore.

Regjistrimi i aktiveve nga llogaria dhe dokumentimi i tyre, lëvizja e vlerave materiale dhe mallrave është bërë mbi bazën e dokumenteve autorizues, (urdhër veprimi, plan shpërndarje), duke i plotësuar dokumentet justifikues me të dhënat e nevojshme, mbi bazën e të cilave janë kryer edhe regjistrimet përkatëse në librat e llogarisë.

Kuadrimi ndërmjet përgjegjësin materiale që ka në ruajtje e administrim aktivet e magazinës qendrore me shefen e llogari financës të filialit është bërë për çdo muaj.

U kontrollua mbartja e saldove në mbylljet dhe çeljet e periudhave ushtrimore dhe rezultoi se ato mbahen konform kërkesave të kontabilitetit. Pavarësisht punës së bërë për regjistrimin e aktiveve dhe dokumentimin e lëvizjes së tyre, nga auditimi i kësaj çështje u konstatuan dhe të meta e mangësi në këto drejtime:

- Nga vlerësimi i rregullshmërisë së shkarkimit nga librat e llogarisë të aktiveve të konsumit, si: karburante, materiale elektrike, hidraulike, kancelari, aktive të higjienës e pastrimit, konstatohet se këto aktive janë shkarkuar direkt nga magazina qendrore vetëm me fletë dalje, pa pasur një dokument argumentues për përdorimin e shkarkimin e tyre dhe as nuk janë përcaktuar norma konsumi, duke vepruar në shkelje të kërkesat e ligjore. Në fakt shkarkimi duhej të bëhej me proces verbal për çdo muaj, të miratuar nga Drejtori Administrativ i QNOD-së dhe i nënshkruar nga jo më pak se dy persona, përveç përgjegjësit material.
- Aktivitet e vendosura në zyrat e personelit të QNOD-së shkarkohen padrejtësisht nga magazina qendrore, si dalje të jashtëme, dhe ngarkohen punonjësit e zyrave, kur në fakt ato duhet të jenë gjendje në inventarin e magazinës dhe kalimi tek punonjësit të bëhet nëpërmjet kartelave kundrejt nënshkrimit të tyre.
- Administrimi dhe shkarkimi i karburantit, nuk është bërë konform kërkesave ligjore, pasi në shkarkimin e karburantit, nuk ka urdhër apo plan shpërndarje, nuk është hedhur sasia e karburantit të tërhequr nga drejtuesit e mjeteve, s'bëhet analizë për konsumin e shkarkimin e karburantit dhe fletët e udhëtimit nuk janë sipas modelit të miratuar nga Ministria e Mbrojtjes

Rekomandim: Drejtori Administrativ i QNOD-së të përgatisë udhëzim me detyra të specifikuara për punonjësit autorizues e zbatues, për ruajtjen, administrimin dhe shkarkimin e aktiveve materialë, mbështetur në kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe në udhëzimin e MF-së nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Procesi i vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve:

Për të gjithë periudhën objekt auditimi dhe u konstatua se nuk është kryer asnjë një procedurë seleksionimi të aktiveve

Vleresimi i sistemit të kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi, ligjshmërinë e kryerjes së inventarizimit të aktiveve.

Objektivi i audituesit në auditimin e kësaj fushe, si një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve, ishte vlerësimi i punës të bërë nga komisionet e inventarizimit për respektimin e kërkesave ligjore në kryerjen e inventarizimit për të gjitha aktivet që ka njësia, ngritjen e komisioneve, kryerjen në kohë të inventarizimit, me saktësi e cilësi, për të dhënë gjendjen reale fizike të aktiveve në një kohë të caktuar, punën e bërë nga përgjegjësit materialë për administrimin, ruajtjen e mirëmbajtjen e aktiveve, nxirjen e rezultatit të inventarizimit, pasqyrimin e tyre në librat e llogarisë dhe dhënien e rekomandimeve për eliminimin e mangësive të konstatuara.

U auditua procesi i inventarizimit për aktivet në administrim të QNOD-së për vitet 2016 -2018, Për çdo vit Drejtori Administrativ ka nxjerr urdhra të brendshëm për kryerjen e inventarizimit të aktivet qarkulluese përfshi dhe aktivet me afat te gjate përdorimi. Në këto urdhra janë përcaktuar komisionet e inventarizimit, afatet e fillimit e të mbarimit të inventarëve, raportimit të dhënave operative, dërgimi i rezultateve përfundimtare dhe relacioni përkatës. Fletët e inventarit të aktivet material janë nxjerrë të veçanta, sipas emërorit të materialeve, numrit kodik kategorisë së mallrave dhe klasave të llogarive të përcaktuara në standardet e rregullat e kontabilitetit.

Nga auditimi i kësaj çështje rezultuan mangësi të cilat po i paraqesim më poshtë:

- Fletët e inventarit për të tre vitet nuk kanë të shënuar datën e fillimit dhe të mbarimit të inventarizimit, ato të gjitha mbajnë datën 31.12, të vitit përkatës, datë kjo që pasqyron gjendjen kontabël të datës 31 dhjetor të çdo viti dhe në asnjë rast nuk janë administruar nga sekretaria, nëpërmjet protokollimit të tyre.
- Në urdhra e brendshëm për kryerjen e inventarizimit të aktiveve nuk janë përcaktuar afatet e kryerjes së inventarëve për cdo objekt dhe njësi inventarizuese, nuk janë përcaktuar udhëzime mbi rregullat e kryerjes së inventarëve, kuadrimet raportimet dhe informacioni që do i dërgohet drejtimin në lidhje me përfundimin e inventarëve.
- Aktivet që ndodhen nëpër zyra nuk janë në administrim të magazinierit materialisht përgjegjës, por i kanë në admistrim punonjësit e administratës.
- Nuk është kryer inventar për ndërtesën në administrim të QNOD-së.

Rekomandime: I rekomandohet përgjegjësit të sektorit të financës të zbatojë kërkesat ligjore për procedurat e kryerjes së inventarizimit të aktiveve dhe detyrimeve”, para fillimit të inventarizimit të vlerave materiale të bëjë punë paraprake studimore efektive për përvetësimin e kërkesave ligjore që kanë të bëjnë me inventarizimin e vlerave materiale. Aktivet e vendosura në zyrat e punonjësve të këtij institucioni të administrohen nga magazinieri dhe ruajtja e tyre të bëhet nga punonjësit e administratës nëpërmjet kartelave dhe nënshkrimit të tyre nga punonjësit që i kanë nëpër zyra. Krahas kryerjes së inventarizimit të

merave materiale jo më pak se njëherë në vit të kryhet inventarizimi i plotë i ndërtesave duke i pajisur ato me kartelat përkatëse. (Librezat e ndërtesave).

Vlerësimi i dokumentacionit për inventarizimin e pronave, regjistrimin e tyre dhe nxjerrja e certifikatave të pronësisë.

Objektivi i auditimit është: Procedura e ndjekur për regjistrimin e pronave; Vlerësimi i procedurave dhe rregullave të vendosura dhe zbatuara nga Drejtimi i QNOD-së, për përgatitjen e dosjes së pronave me dokumentacionin teknik të domosdoshëm për inventarizim, në përputhje me kërkesat ligjore dhe ato n/ligjore.

Në administrim të QNOD-së ndodhet vetëm godina 3 katëshe "Ish Komanda e FD-së, Plepa, Durrës" Gjatë vlerësimit të dokumentacionit teknik të hartuar nga ISPMb e IGJU dhe krahasimi i sipërfaqeve të pronave në këtë dokumentacion me atë të regjistruar në zyrat e RPP dhe me inventarin e përcaktuar në VKM Nr. 515, datë 18.07.2003 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore" i ndryshuar me VKM Nr. 737, datë 16.10.2012 dhe VKM nr.220, datë 21.03.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 515 ...," dhe konstatohet se në dosjen e kësaj prone nuk ndodhet dokumentacioni teknik dhe ligjor (Certifikata e pronësisë) e lëshuar nga ZRPP, Durrës.

Rekomandime: Drejtimi Administrativ i QNOD- së të kërkojë zyrtarisht dokumentacionin e nevojshëm tekniko ligjor të godinës tre katëshe, e cila aktualisht është në administrim të QNOD-së, e kontabilizuar edhe në pasqyrat financiare të këtij institucioni dhe të krijojë dosjen e pronës sipas kërkesave ligjore.

4. Vlerësimi i procedurave dhe rregullave në dokumentimin e vlerave monetare, zbatimi i ligjshmërisë për veprimet e kryera nëpërmjet arkës dhe bankës:

Objektivi i auditimit ishte vlerësimi i procedurave dhe rregullave në dokumentimin e veprimeve të kryera nga banka, përputhshmërisë së veprimeve me ligjet dhe rregullat, mbajtja dhe organizimi i bankës si dhe vlerësimin e pagesave të kryera, për rregullshmërinë e dokumentacionin justifikues mbi të cilin janë kryera transaksionet financiare, regjistrimin në kontabilitet të lëvizjeve arkëtim-pagesave të kryera nëpërmjet bankës.

Kërkesë transaksionet përpilohen dhe nënshkruhen nga përgjegjësi i sektorit të financës, si dhe janë të miratuara nga Drejtori Ekzekutiv i QNOD-së, nëpërmjet nënshkrimit të tij. Detyrën e përgjegjësit të sektorit të financës së QNOD-së e ka kryer z. Petraq Tokri për periudhën nga 01.01.2016 - tetor 2018 dhe pas kësaj date këtë detyrë e ka kryer z.Muharrem Shkurta.

Gjatë ushtrimit të misionit të auditimit, për periudhën objekt auditimi, në sistemin e pagesave për aktive e shërbime dhe respektimin e detyrimeve përkatëse ligjore në veprimet e pagesave nëpërmjet bankës, u konstatua se likuidimet janë kryer kryesisht nëpërmjet procedurave të prokurimit me blerje të vogla, vlerësimi i të cilave është bërë në çështjen "Procedurat e zbatuara për prokurimet me fonde publike me vlera të vogla".

Audituesi për të përcaktuar saktësinë e likuidimit të faturave të furnizimit, respektimin e kushteve të vendosura në kontratë, dokumentacionin argumentues e justifikues, pritjen e mallrave të furnizuara, aplikimin e drejtë të çmimeve të mallrave të blera, krahasimin e tyre me ato të përcaktuara në kontratë etj. bëri vlerësimin e të gjitha pagesave të kryera nëpërmjet bankës dhe rezultoi si vijon:

Nëpërmjet aktivitetit të bankës janë kryer vetëm shpenzime për telefon, pagat e punonjësve, derdhjet për kontribute të sigurimeve shoqërore, shëndetësore, tatimet, blerje të vogla, të cilat janë trajtuar në çështje të veçantë.

Konstatohet se nuk janë kryer pagesa për energji elektrike dhe shpenzime për ujë të pijshëm për periudhën 01.01.2016-31.12.2018, për faktin se ato janë kryer nga Komanda e Forcës Detare.

shpenzimet telefonike, në të gjitha rastet nuk janë firmosur nga përfaqësues të autorizuar nga QNOD, Plepa, Durrës, me qëllim kontrollin e kryerjes së këtyre shpenzimeve.

Procedurat dokumentare rezultojnë të rregullta dhe nuk u konstatuan likuidime të gabuara.

Opinionimi i auditit është se përgjegjësi i financës, në asnjë rast të mos likujdojë fatura të shpenzimeve telefonike pa nënshkrimin e tyre nga një person i caktuar për të ndjekur dhe kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme shpenzimet e kryera.

Pagesa e shpenzimeve për udhëtim e dieta brenda vendit:

Gjatë angazhimit të auditimit, me zgjedhje, për vlerësimin e kryerjes së shpenzimeve për udhëtim e dieta, brenda vendit, për punonjësit e QNOD-së konstatohet se, për periudhën 01.01.2016- 31.12.2018, pagesat janë bërë sipas kërkesave të VKM-së nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit". Gjatë auditimit nuk u konstatuan parregullsi në pagesat për shpenzime udhëtimi e dieta si më poshtë:

- Autorizimet e lëshuara nga titullari për dërgimin me shërbim të punonjësve janë plotësuar në rregull, duke përcaktuar destinacionin dhe qëllimin e shërbimit, por janë pa numër protokollit dhe të pa sekretuara, veprime këto, në kundërshtim me kërkesat që përcakton pika 2, e VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar.
- Përlllogaritjet e dietave janë bërë të sakta dhe nuk u konstatuan mangësi në pagesat e tyre.

Në vlerësimin e pagesave nga vendimet gjyqësore, konstatohet se me urdhër shpenzimi nr.28, datë 17.03.2017 dhe nr.34, datë 03.04.2017 i janë paguar 1,074,358 lekë (19.5 paga mujore) një ish punonjëse të QNOD-së Durrës, sipas Vendimit nr.82-2015-1305(1453), datë 29.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës, e cila është larguar nga QNOD-ja.

Gjithashtu konstatohet se me urdhër shpenzimi nr.38, datë 24.04.2018 dhe nr.42, datë 02.05.2018 i janë paguar 329,616 lekë (9 paga mujore) një ish punonjësi të QNOD-së Durrës, sipas Vendimit nr.241, datë 16.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës dhe vendimit nr.404,86-2018-439, datë 06.02.2018, e cili është larguar nga QNOD-ja.

Observacioni i paraqitur nga subjekti i audituar për largimin dy punonjësve nga puna për shkak të ristrukturimit të institucionit është marrë në konsideratë nga auditimi dhe ndryshimet janë reflektuar në raportin përfundimtar

Nga auditimi i mënyrës se organizimit dhe mbajtjes se kontabiliteti të bankës, rezultoi se kontabiliteti është i informatizuar dhe mbahet me programin Financa -5. Në ditarin e bankës veprimet janë pasqyruar në mënyrë kronologjike sipas kohës së ndodhjes dhe qëllimit të kryerjes së pagesës. Llogaritë janë hapur dhe kanë funksionuar sipas legjislacionit kontabël, duke pasqyruar çdo pagesë sipas natyrës së tyre, pagesës së pagave të punonjësve, derdhjen e kontributit të sigurimeve shoqërore,shëndetësore, pagesat për shpenzime telefonike etj.

Aktiviteti ekonomik - financiar i QNOD-së është kryer nëpërmjet aktivitetit të Bankës Kombëtare Tregtare, Bankës Credins dhe Raiffeisen Bank për periudhën 01.01.2016 - 31.12.2018. Nuk janë kryer veprime nëpërmjet aktivitetit të arkës për të gjithë periudhën objekt auditimi.

Procedurat e blerjeve me vlera të vogla nëpërmjet aktivitetit të bankës të QNOD

Për periudhën nga 01.01.2016-31.12.2018 për nevoja të këtij institucioni janë kryer shpenzime tepër të vogla nëpërmjet aktivitetit të bankës, me 34 procedura prokurimi për blerje me vlera të vogla në shumën 1,596,549 lekë. Nëpërmjet këtyre procedurave janë blerë kancelari e shtypshkrime, materiale pastrimi dhe materiale të ndryshme konsumi dhe shërbime për mirëmbajtjen e ambienteve të QNOD-së. Në vlerësimin e procedurave të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla konstatohet se :

- Në tre raste faturat e lëshuara nga operatorët ekonomik nuk janë firmosur nga dy anëtarë të komisionit të blerjeve me vlera të vogla, por ato janë firmosur vetëm nga një anëtar i komisionit.
- Në 2 raste, nuk ka proces verbal për dorëzimin e automjetit për riparim tek operatori ekonomik riparues dhe nuk ka proces verbal të marrjes në dorëzim prej tij.
- Në procedurat e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, KPVV nuk përcakton të dhëna mbi identitetin e operatorëve ekonomikë, si lloji i biznesit që kryen, (i biznesit të vogël apo të madh me TVSH), adresa, etj.

Observacioni i paraqitur nga subjekti i audituar për përgatitjen e kërkesave, argumentimin e fondit limit dhe përdorimin e procedurës “blerje me vlerë të vogël në formë shkresore” është marrë në konsideratë nga auditi dhe është reflektuar në raportin përfundimtar

5. Funkcionimi i sistemit të kontabilitetit, zbatimi i rregullave në njohjen e shpenzimeve, llogaritë, ditarët, libri i madh, përgatitja e pasqyrave financiare:

Për organizimin e mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare nga ana e specialistit të financës është punuar pjesërisht në mënyrë elektronike me programin “Alfa Eeb”, duke u mbështetur në dokumentacionin bazë kontabël (faturat e blerjeve, mandat arkëtimet, mandat pagesat, fletë hyrjet, fletë daljet, fletë shoqërimet, situacionet e punimeve, proces verbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit etj.).

Gjatë ushtrimit të misionit të auditimit të bilancit u bë vlerësimi për regjistrimin e të dhënave të rubrikave, posteve dhe llogarive kontabile, saktësinë dhe plotësinë e paraqitjes së tyre duke krahasuar të dhënat e bilancit objekt auditimi (v. 2018) me ato të bilancit të vitit të mëparshëm (v. 2017). Nga auditimi u bënë përlllogaritjet e të dhënave në këto ditarë, u bë krahasimi i tyre me ato të pasqyruara në bilanc dhe u konstatua se në përpilimin e tij ka disa pasaktësira dhe përlllogaritje të gabuara si më poshtë:

Gjetje e konkluzione: Nga vlerësimi i llogarive të bilancit konstatohet se llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, në fund të viteve 2017 dhe 2018 paraqitet me tepricat debitorë përkatësisht në shumat 25,471,510 lekë dhe 25,272,845 lekë. Për të përcaktuar vlerën reale të ndërtesës tre katëshe në pasqyrat financiare, auditi nuk jep opinion, për faktin se nuk ndodhen dokumentet teknike dhe ligjore të kësaj prone për të përcaktuar vlerën e saktë të saj.

Në vlerësimin e llogarive të bilancit konstatohet se 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 218 “Inventari ekonomik”, në bilancet e periudhës së audituar nuk janë pasqyruar me vlerën reale të tyre. Në këto llogari janë përfshirë padrejtësisht edhe zëra të llogarive të tjera. Në llogarinë 32 “Materiale” janë përfshirë padrejtësisht aktive të cilat i përkasin llogarisë “Objekte inventari”. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për llogarinë 31 “Materiale”, në të cilin janë përfshirë padrejtësisht zëra që u përkasin llogarive të tjera. Mos pasqyrimi i saktë i llogarive, sipas klasifikimit dhe standardeve e rregullave kontabël ka bërë që pasqyrat financiare të mos japin një informacion të saktë dhe real. Për pasqyrimin e tepricave debitorë të llogarive të mësipërme specialistja e degës së financës nuk është mbështetur në dokumente të kontabilitetit, nuk është mbajtur llogari e saktë nga ky sektor dhe ka munguar bashkëpunimi me sektorin e infrastrukturës.

Llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” është pasqyruar në mënyrë reale, për faktin se llogaritja e amortizimit të AAM është llogaritur për çdo zë të AAM. Gjithashtu konstatohet se në postin “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët”, llogaria 429 “Personeli, paradhënie e gjoba” në fund të vitit 2017 dhe 2018 rezulton pa tepricë debitorë, që tregon se puna e

oërë nga ana e këtij sektori ka qenë në lartësinë e duhur në drejtim të arkëtimit të detyrimeve ndaj QNOD-së.

Si pjesë përbërëse e pasqyrave financiare edhe aneksi i dhënies së informacionit, duhej të paraqiste informacion të plotë konciz dhe të saktë, për faktin se, në të dhënat sqaruese nuk jepej një informacion i tillë, gjë që në të ardhmen shefi i sektorit të financës, si përgjegjësi i mbajtjes dhe përpilimit të pasqyrave financiare, të sqarojë më mirë të gjitha ngjarjet dhe transaksionet që kanë ndodhur gjatë periudhës raportuese, duke i ballafaquar me shkaqet e realizimit e mosrealizimit të tyre.

Mangësitë e konstatuara në mbajtjen e kontabilitetit dhe në hartimin e pasqyrave financiare nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen financiare, performancën dhe ndryshimet në gjendjen financiare.

Rekomandime: Titullari QNOD-së, të marrë masa duke i vënë detyra degës të financës për:

- Tërheqjen e dokumentacionit tekniko ligjor të ndërtesës tre katëshe nga Komanda e Forcës Detare, si dhe hapjen e dosjes së kësaj prone sipas kërkesave ligjore.
- Klasifikimin dhe kontabilizimin e llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Aktiveve Afatshkurtra Materiale duke plotësuar edhe dokumentacionin e nevojshëm ligjor, konform rregullave të administrimit dhe standardeve kontabël.
- Saktësimin dhe rakordimin e llogarive me të dhënat kontabël dhe pasqyrimin e saktë të tyre në mbylljen e vitit ushtrimor pasardhës.
- Përmirësimin e formulimit të aneksit të informacionit për dhënien informacion të plotë konciz dhe të saktë, sqarimin më mirë të gjitha ngjarjeve dhe transaksioneve që kanë ndodhur gjatë periudhës raportuese, duke i ballafaquar me shkaqet e realizimit e mosrealizimit të tyre.

6. Zbatimi i afateve dhe plotësimi i dokumentacionit për qarkullimin pa pagesë të vlerave materiale

Objektivi i auditimit është vlerësimi i procedurave dhe rregullave të vendosura dhe të zbatuara nga QNOD-ja për ndjekjen, qarkullimin dhe administrimin e aktiveve materiale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Realizimi i këtij misioni u mbështet në VKM nr. 45, datë 14.2.1994 "Për qarkullimin pa pagesë të vlerave materiale" dhe Udhëzimit të MM nr. 281, datë 31.07.2001 "Për qarkullimin pa pagesë të vlerave materiale brenda sistemit të Forcave të Armatosura", dalë në zbatim të këtij vendimi, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", pika 2 e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël". Nga auditimi i kësaj çështje u konstatua se nuk ishte dokumente të pa kompletuara të gjitha fletë daljet ishin të kompletuara me konfirmim marrje në përputhje me kërkesat e legjislacionit të cituar më lart.

Si mangësi u konstatua se nga ana e sektorit të llogarisë (financës) nuk mbahet libri mod.KSU-13/1 "Për qarkullimin pa pagesë të vlerave materiale", për të cilin i lihet **rekomandim** financës që të marrë masa për mbajtjen e këtij libri.

7. Administrimi i të ardhurave të krijuara nga dhënia me qera e objekteve, punimeve e shërbimeve të ndryshme për të tretët, rregullat në njohjen dhe kontabilizimin e tyre:

Për periudhën objekt auditimi QNOD-ja nuk ka realizuar të ardhura nga dhënia me qera e objekteve, për faktin se nuk ka dhënë objekte me qera. Të ardhura janë krijuar vetëm nga arkëtimet e kryera nga debitorët e këtij reparti, të cilat janë derdhur rregullisht në degën e thesarit.

8. Zbatimi i ligjshmërisë për projektet me financime të huaja:

Për periudhën objekt auditimi në QNOD nuk ka pasur projekte me financim të huaj, për rrjedhojë kjo procedurë nuk u auditua nga grupi i punës konkluzion ky i arritur në përputhje me metodën e intervistimit të përdorur nga auditi.

III. Auditimi i Blerjeve dhe Prokurimeve

Për periudhën e auditur QNOD referuar regjistrin të parashikimit të prokurimit publik dërguar MM për periudhën 2016 -2018 rezulton se :

Për vitin 2016 autoriteti kontraktor ka dërguar në MM regjistrin e parashikimit PP nr. 54, datë 20.01.2016 ku janë parashikuar 10 procedura prokurimi me vlerë të vogël në një vlerë totale 780,798 lekë për gjithë vitin buxhetor.

Për vitin 2017 autoriteti kontraktor ka dërguar në MM regjistrin e parashikimit PP nr. 85, datë 09.02.2017 ku janë parashikuar 12 procedura prokurimi me vlerë të vogël në një vlerë totale 1,040,829 lekë për gjithë vitin buxhetor.

Për vitin 2018 autoriteti kontraktor ka dërguar në MM r regjistrin e parashikimit PP nr. 28, datë 10.01.2018 ku janë parashikuar 12 procedura prokurimi me vlerë të vogël në një vlerë totale 1,240,000 lekë për gjithë vitin buxhetor.

Nevojat për punë mallra dhe shërbime kjo njësi i ka realizuar nëpërmjet përdorimit të procedurave “blerje me vlerë të vogël”, të audituara në aktivitetin e bankës.

Bazuar në gjetjet e konstatuara dhe trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, mbështetur në shkronjën “e” të nenit 16 të ligjit nr.114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manualin e AB dhe në aktet e tjera ligjore dhe nën ligjore që lidhen me auditimin, me qëllim përmirësimin e punës, grupi i auditit rekomandon:

I. MASA ORGANIZATIVE

1. Drejtori Administrativ i QNOD të analizojë problemet e trajtuara në raportin përfundimtar të auditimit dhe bazuar në nenin 12, germa “d”, të ligjit nr.114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe nenit 11 të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të marrë masat përkatëse për hartimin e Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të Auditimit.
2. Drejtori Administrativ i QNOD, për një menaxhim më me efektivitet të aktiveve në përdorim të njësisë, të përgatisë dhe të miratojë udhëzime/rregullore specifike të brendshëm, për procedurat, rregullat dhe dokumentacionin e kërkuar për administrimin e aktiveve që përdoren nga ky institucion për funksionimin sipas aktiviteteve, për ruajtjen, mirëmbajtjen e objekteve dhe ambienteve të njësisë, sipas kërkesave të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ndryshuar dhe legjislacionin që rregullon veprimtari të tjera që ushtrohen nga kjo njësi,
3. Drejtori i Planifikimit dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Shefi i Financës të marrë masa për organizimin, mbajtjen dhe zbatimin e kontabilitetit, pasqyrimin e vlerës reale të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara, në regjistrimin dhe klasifikimin e tyre, sipas kërkesave që përcakton ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar;

4. Drejtori i Planifikimit dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Shefi i Financës të marrë masa për hapjen menjëherë të regjistrimit të pagave të çdo punonjësi me të gjithë elementët e tij (pagat për funksion, shtesat dhe ndalesat etj të dhëna sipas udhëzimeve për këtë qëllim).
5. Drejtori i Planifikimit dhe Shërbimeve Mbështetëse për çdo muaj, të analizojë me përgjegjësi realizimin e limitit dhe zbatimin e normativave të karburantit, në përputhje me kërkesat e urdhrin e MM-së nr. 2089, datë 30.12.2015. "Për miratimin e normativave të karburant - lubrifikanteve për mjetet motorike në përdorim të Forcave të Armatosura", të evidentojë mangësitë duke nxjerrë dhe përgjegjësitë për problemet që dalin.
6. Drejtori i Planifikimit dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Shefi i Financës në urdhrat e brendshëm për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të përcaktojnë afatet e kryerjes së inventarëve për çdo objekt, komisionet dhe mënyrën e raportimit sipas kërkesave të udhëzimit të MF-së nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".


II. TË PËRGJITHSHME

1. Drejtori Administrativ i QNOD mbi bazën e parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit, brenda 20 ditëve nga marrja e këtij raporti, të hartojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit dhe të bëjë konfirmimin e raportit përfundimtar në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në MM.

Ky raport përfundimtar auditimi mbahet në 2 (dy) kopje, nga të cilat 1 (një) kopje i dërgohet QNOD dhe 1 (një) mbahet në sekretarinë e MM.

Për grupin e punës së Auditimit

Edvin ZOTO



DREJTORI I AUDITIT

Edmond GORE

